



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljezi/Prisuto Received/Deliverty	07-02-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	587/2022		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.03/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.03/2022 të datës 05.01.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat nga kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.03/2022 të datës 05.01.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës, me datë 05.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 05/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Prishtinës, për shkak të mos kompensimit të shujtës ditore dhe pagës jubilarë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit me numër protokoll 2056 të datës 18.04.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 10.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Komuna e Prishtinës. Ndërsa, Këshilli më datë 24.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 03/2022, e datës 05.01.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit me numër protokoll 14-035/01-281346/21 të datës 29.12.2021 drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vërtetimin e datës 27.10.2020; shkresë të lëshuar nga

Drejtori i SHML T.H. T" 7 Shtatori" Prishtinë Nr.472 të datës 08.10.2020; shkresë me numër protokoll 472 t datës 08.10.2020; ID e ankuesit, Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 313/2022, të datës 24.01.2022, Autorizimin për përfaqësim të datës 27.01.2020; Kontratën e punës me numër protokoll 14-111/01-152600/21 të datës 9.07.2021 për Ankuesin

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.03/2022 të datës 05.01.2022, të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga vlerësimi i provave të lëndës respektivisht sipas Kontratës së punës me numër protokoll 14-111/01 – 152600/21 të datës 29.07.2021, është konstatuar se ankuesi është i emëruar në pozitën e punës se Zëvendës Drejtorit në Shkollën e Mesme të Ulët "Ahmet Gashi" në Prishtinë. I njëjti me datë 05.01.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 05/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Prishtinës për shkak të mos kompensimit të shujtës ditore dhe pagës jubilarë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit me numër protokoll 2056 të datës 18.04.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4." *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike",* ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve publike të arsimit para universitar në Kosovë, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik respektivisht pozita e Zëvendës Drejtorit të Shkollës së Mesme të Ulët nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil. Andaj, pas konstatimit se ankuesi ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil dhe, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.03/2022 të datës 05.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, udhëzon ankuesin se nëpunësi e shërbimit publikë ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. Nr. 03/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

